



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr. 5, Datë 30.07.2010

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|------------|
| - Znj. Anila Jani | Kryetar |
| - Z. Bashkim Sykja | Nënkryetar |
| - Znj. Marsida Xhaferllari | Anëtar |
| - Znj. Ledina Mandia | Anëtar |
| - Z. Altin Goxhaj | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 30.07.2010, mori në shqyrtim mënyrën e faturimit të shërbimit të telefonisë fikse, nga operatori ALBTELEKOM sh.a.

Komisioni pas shqyrtimit të çështjes, dhe dëgjimit të përfaqësuesve të Altelekom sh.a,

VËREN SE:

Faturimi në mënyrë të padetajuar, i bërë për shërbimin e telefonisë fikse, nga operatori ALBTELEKOM sh.a, është në kundërshtim me Ligjin nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, Pjesa VII -Kontrata të veçanta, Kreu I – shitja e energjisë, shërbimet e ujit dhe të telekomunikacionit, nenin 40, sipas të cilit:

- **pika 3**, “*Fatura për shërbimet e telekomunikacionit, shpërndarë konsumatorit, duhet të përmbajë informacion të plotë për listën e numrave të telefonave të thirrur, kohën dhe zgjatjen e telefonatave të bëra, numrin e impulseve dhe çmimin total për periudhën e caktuar*”;
- **pika 4**, “*duhet t'i japin mundësinë për të verifikuar me përpikëri llogaritjen e shitjes ose shërbimit të siguruar në një periudhë të caktuar*”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni mbështetur në nenin 40 dhe nenin 55, të Ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, si dhe në pikën 6/a të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008

VENDOSI:

ALBTELEKOM sh.a te ndreqe shkeljen dhe te siguroje qe faturimi për shërbimin e telefonise fikse, për muajin nëntor 2010 e në vazhdim, të behet konform nenit 40 te ligjit nr. 9902, date 17.04.2010 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.

KRYETAR I KOMISIONIT

ANILA JANI